

Relacion

Veprimtaria e UFSH 2015

Sektori Edukimit në Vazhdim

Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë, krahas detyrave të tjera ka për mision edhe ngritjen profesionale të farmacistëve. Nga UFSH kjo është realizuar nëpërmjet hartimit dhe planifikimit të programeve të kualifikimit të vazhdueshëm. Nga analiza që QKEV ka bërë, UFSH rezulton se është ofruesi kryesor për aktivitetet e edukimit në vazhdim për farmacistet në vend. Për të përmbushur sa më mirë detyrimin tonë me profesionistët farmacistë kemi ofruar aktivitete nëpër të gjitha rajonet e Shqipërisë, bazuar edhe në numrin e farmacistëve dhe nevojat për kredite për secilin rajon.

Me qëllim minimizimin e problemeve të evidentuara në përfundimin e ciklit të I-re, UFSH kërkoi të futë në praktikën e vet, rakordimin e krediteve ndërmjet UFSH dhe QKEV në fund të çdo viti. Nuk duhet harruar se cikli i I-rë i riçertifikimit, i cili u mbyll në dhjetor 2014 u ndoq me procedura të mëtejshme, si zbardhja e listave paraprake, kontrolli i tyre, lëshimi i vërtetimeve për personat problematik, etj. Në dhjetor të vitit 2014, UFSH ka dërguar pranë QKEV-së listat sipas numrit identifikues të farmacistëve dhe nevojat totale për kredite të secilit farmacist, në varësi kjo të kartës së anëtaresimit. Këto lista paraprakisht nuk u morën në konsideratë dhe një numër i konsiderueshëm farmacistësh u drejtuan në zyrat tona për tu pajisur me vërtetime individuale me datën e antarësimit gjë e cila sillte një zvarritje të procedurave.

Një tjetër problematik e hasur ishte edhe mospaspqyrimi i saktë i të dhënave të farmacistëve nga ana e QKEV, duke bërë gjithashtu që një pjesë e farmacistëve të vinin në UFSH, dhe të pajiseshin me vërtetime kreditesh, procedur që e shtynte edhe më tepër ardhjen nga QKEV e listave përfundimtare, për pasoj edhe procesin e riçertifikimit. Me ardhjen e listave përfundimtare, më datë 21/05/2015, UFSH nisi menjëher me procesin e riçertifikimit të gjithë antarësisë së saj. Por edhe këto lista sërisht rezultojnë me problem pasi, pavarësisht listave të dërguara prej nesh në muajin dhjetor, aty sërisht rezultonin si persona të pakualifikuar persona të cilëve nuk u nevojiten në fakt kreditet për këtë cikël.

Format e reja të Edukimit në Vazhdim, bazuar edhe në planin paraprak për ciklin të dytë të ricertifikimit që i takon periudhës Janar 2015-Dhjetor 2018, janë **kurset online** dhe **videokonferencat**, këto si një mënyrë bashkëkohore dhe efikase për zhvillimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Parashikojmë që këto të jenë forma të cilat do të na shoqërojnë përgjatë ciklit të dytë të ricertifikimit.

Falenderim për lektorët që ishin mbështetës të këtij procesi të gjatë që kërkon përkushtim dhe profesionalizem si prof. Skender Durrësi, Dr. Anila Aliko, Dr. Polikron Pulluqi, Dr. Monika Fida, Dr. Melisa Troshani, Dr. Rilinda Klosi, Drini Dobi, Henrrik Prendushi etj

Kursi i parë i Edukimit në Vazhdim nëpërmjet formës online u zhvillua në një periudhë një mujore (23 shkurt – 23 Mars), duke i dhënë në këtë mënyrë secilit farmacist mundësinë e pjesëmarrjes. Duke qënë se kjo formë aplikohet për herë të parë nga UFSH, Kooperacioni Zvicerian ishte përkrahësi dhe mbështetës shumë i rëndësishëm në realizimin me sukses të kësaj forme të edukimit në vazhdim dhe u ofrua për **farmacistët pa pagesë** Njoftimi për zhvillimin e kursit u vendos në faqen e UFSH dhe për rreth 30 ditë specialistja e edukimit në vazhdim ka sqaruar çdo pyetje të drejtuar nga farmacistet në lidhje me menyrën e zhvillimit të tij. Videokonferencat për 6 mujorin e parë u zhvillua në rajonet: Lezhë, Dibër, Durrës, Kukës, Elbasan, Fier, Korçë, Berat duke ofruar 6 kredite për secilin rajon.

Në 6 mujorin e dytë Vidiokonferencat u shtrinë në të gjitha rajonet: Dibër, Kukës, Lezhë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë. Janë zhvilluar po ashtu edhe aktivitete *face to face* si në Tiranë ashtu edhe në disa rajone si Vlora, Gjirokastra, Shkodra ku janë aktivizuar lektorët rajonal. Në kuadër të Edukimit në Vazhdim, por edhe në funksion të rritjes së cilësisë së tij si dhe shtrirjes së bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë si brenda vendit dhe jashtë tij, UFSH ka qenë bashkëorganizator me dy nga Universitetet private më në zë të Shqipërisë. Përkatësisht u organizuan **dy Konferenca Ndërkombëtare** me Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë”, dhe “Albanian University”. Me ZKM u zhvilluar me **10 prill 2015**, dhe me Albania UNY me **13 Qershor 2015**, te dyja perkatesisht me **nga 8 Kredite** secila. Në këto aktivitete morën pjesë, ndër lektorët më në zë të universiteteve të Milanos, Napolit, Pizës e sigurisht të Shqipërisë. Të dyja këto aktivitete kishin mundësi të ndiqeshin nga të gjitha rajone. Nderkohe gjatë 6 mujorit të dytë të 2015, duke shfrytëzuar edhe mundësinë e ofruar nga Qendra e Telemjekësisë së Shqipërisë, kemi ofruar rreth 15 kredite për secilin rajon të Shqipërisë, aktivitete të cilat për rajonin e Tiranës, si rajoni me numrin më të madh të pjesëmarrësve secili aktivitet është përsëritur 3 herë. Në datën 11 dhjetor të këtij viti u organizuar një tjetër aktivitet me 5 kredite, i ofruar për 12 rajone plus edhe Tropojë dhe Sarandë, **pa pagesë** për pjesëmarrësit.

Problematikat e hasura nëpër aktivitetet e edukimit në vazhdim janë :

- Tendencat për fiktivitet në pjesëmarrje
- Farmacistet janë pasiv në përcjelljen e tematikave të nevojshme, të cilat sjellin si rezultat
- Aktiviteti nuk zgjat sipas përcaktimit të programit

Në total për rajonin e Tiranës për vitin 2015 janë ofruar 38 kredite, për rajonin e Durrësit 27 kredite, për rajonin e Fierit 27, atë të Vlorës 26, Elbasanit 27, Korçës 26, Beratit 26, Gjirokastrës 27, për rajonin e Lezhës, Dibrës, Kukësit nga 26 kredite, për rajonin e Shkodrës 24 kredite. Në seminarin e fundit u realizua lidhja dhe me dy qytete të skajshme atë të Sarandës, e Tropojës. Këtyre vlerave duhet ti shtohen edhe 20 kredite të ofruara nga kursi online, i cili ishte i akredituar me 12 kredite dhe nga konferenca e organizuar nga Albania University dhe ZKM me 8 kredite. Pas përfundimit të aktivitetit të fundit të datës 11 Dhjetor, nisi përpunimi i krediteve për secilin farmacist të ofruara nga UFSH për vitin 2015. Pasi dolën raportet totale, listat me kreditet u dërguan presidënteve rajonal në mënyrë që të rakordoj cdo anëtar i UFSH, si dhe QKEV për të bërë rakordimet vjetore. Bashkëlidhur pasqyra përmbledhëse e Edukimit në Vazhdim, për vitin 2015:

Aida Keçi

Specialiste e Edukimit në Vazhdim